



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI I KULTURËS FIZIKE

Prishtinë

Programi mësimor i lëndës:

“METODAT KËRKIMORE SHKLENCORE”

Prof. as. Dr. Fetah Reçic

Prishtinë, 2006

I. QËLLIMI

- të njohë studentet me strukturën, përmbajtjen, format dhe fushat e organizimit të kërkimit shkencor
- t'i afësoj studentet për realizimin në praktikë të kërkimit shkencor dhe t'u krijojë kushte për përgatitjen e mikrotezës
- t'i parapregatisë me aftësi e dije të mjaftueshme për mbrojtjen e tezës së punimit të diplomës, magjistraturës dhe doktoratës

II. OBJEKTIVAT E PËRMBAJTJES

Gjate periudhës së studimeve, studentet të marrin dijet e nevojshme:

- Për qëllimet, objektivat specifike dhe finalitetet e kerkimit shkencor
- Për metodat dhe teknikat e kërkimit shkencor
- Për planifikimin dhe evidencën e kërkimit shkencor
- Për përmbajtjen e kërkimit shkencor, me theks në konceptet, tezat, ligjësit e shkencave shoqërore e ato të natyrës
- Për format kryesore të shprehjes së kërkimit shkencor
- Për fushat (linjat) dhe organizimin operativ të kërkimit shkencor

III. MODULET, LINJAT DHE NËNLINJAT E PROGRAMIT

- **Moduli i I:** Struktura e kërkimit shkencor
 - ✓ Përcaktimi i qëllimeve të kërkimeve shkencore
 - ✓ Formulimi i objektivave të kërkimit shkencor
 - ✓ Parashimimi i metodave kryesore të kërkimit shkencor
 - ✓ Parashikimi i teknikave – bazë të kërkimit shkencor
 - ✓ Praktikat e planifikimit dhe mënyra e evidencës në kërkimin shkencor
 - ✓ Grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave statistikore për hartimin e një punimi shkencor
 - ✓ Roli i informacionit në punimin shkencor
 - ✓ Rëndësia e informacionit për punimin shkencor
- **Moduli i II: Përmbajtja e punimit shkencor**
 - ✓ Konceptet, dukurit, tezat dhe ligjësitë e shkencave shoqërore e humane
 - ✓ Konceptet, dukurit, tezat dhe ligjësitë e shkencave natyrore
 - ✓

- ***Moduli i III: Format kryesore të kërkimit shkencor***
 - ✓ Finalizimi i kërkimit shkencor në mikronivel
 - ✓ Finalizimi i kërkimit shkencor në makronivel
- ***Moduli i IV: Fushat dhe organizimi i kërkimit shkencor***
 - ✓ Fushat e kërkimit shkencor
 - ✓ Organizimi i kërkimit shkencor

IV. MËNYRA E APLIKIMIT

- ❖ *Puëa e pavarur, puna në grupe për hartimin e skemave bazë të metodave, teknikave dhe të planifikimit të kërkimeve shkencore, në përputhje me mikrotezat e zgjedhura, përfundimet*
- ❖ *Punë individuale dhe në grupe për konceptimin, planifikimin dhe trajtimin e ideve kryesore të finalizimit të kërkimit shkencor në mikronivel dhe makronivel*
- ❖ *Punë individuale dhe në grupe për për linjat dhe nënlinjat kryesore të kërkimit shkencor me shembuj konkret në sport*
- ❖ *Punë individuale dhe në grupe me objektet “mikrotezën” për procesin operativ të studimit (detyra, teste, vijushmëria, evidenca) si dhe për procesin e hartimit të materialit (struktura, linjat etj.).*

V. OBJEKTIVAT

- Në përfundim të ligjeratave, studentet të jenë në gjendje:*
- ✓ *Të njohin, kuptojn dhe zbatojn praktikisht metodat, teknikat dhe planifikimin kërkimor shkencor*
 - ✓ *Të njohin, kuptojn dhe argumentojn linjat dhe nënlinjat kryesore të përmbajtjes kërkimore shkencore në shkencat shoqërore dhe ato të natyrës*
 - ✓ *Të njohin konceptet specifike si dhe strukturën dhe përmbajtjen finale të kërkimit shkencor në makro dhe mikronivel*
 - ✓ *Të argumentojn nevojën e kërkimit shkencor në linja e nënlinja specifike varësisht nga lloji i kërkimit shkencor dhe natyrës së objektit*
 - ✓ *Të realizojë në praktik procesin operativ të studimit të mikrotezës dhe hartimin e materialit përfundimtar (punimin seminarik, punimin e diplomës, punimin e magjistraturës, dhe doktorratën)*

VI. METODOLOGJIA E VLERËSIMIT

- ✓ *Nëpërmjet aktivizimit të studentve në praktikata e punës kërkimore shkencore me materialet konkrete të përgatitura nga ata (proceset inkurajuese)*

- ✓ *Nëpërmjet mbrojtjes së mikrotezës në komisionin e ngritur për këtë qëllim*

VII. NDËRTIMI I NOTËS

- ✓ *Vijushmëria dhe aktiviteti në periudhen e ligjeratave dhe ushtrimeve
10% e provimit*
- ✓ *Hartimi i punimit dhe suksesi i tij në mbrojtje para komisionit
10% e provimit*
- ✓ *Testi i parë (pars përfundimit të gjysmës së parë me ligjerata)
15% e provimit*
- ✓ *Testi i dytë (pars përfundimit të gjysmës së dytë me ligjerata)
15% e provimit*
- ✓ *Provimi përfundimtar
50% të provimit*

VIII. LITERATURA

- ✚ *Si të shkruajm një punim shkencor, Tiran 2004*
- ✚ *Të shkruajm: Ese, Tiran 2004*
- ✚ *Të shkruajmë: Pprocessi dhe shkrimi funksional, Tiran 2004*
- ✚ *Si te behet një punim diplome, Tiran 1997*
- ✚ *Metodologjia e kërkimit shkencor, Angjelko Runjiq, Zagreb, 2004*